



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 17.04.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku-nënkryetar i parë, Ganimete Musliu, Anton Quni, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj-Kryetar dhe Bojan Mitiq-nënkryetar i dytë.

Përfaqësuesit nga Inspektoriati Policor i Kosovës: Fitim Shishani-Kryeshef, Arben Vrajolli-Departamenti i Inspektiveve në IPK dhe Miradije Kelmendi-Drejtorja për shqyrtimin e ankesave në IPK.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- Zyra e Presidentes së Kosovës; Plator Avdiu-QKSS, Hendrik Groeneveld-EULEX, Sanije Berisha- OSBE, Drita Perezic-ICITAP dhe Arbanë Pireva- praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, nënkryetari i parë i Komisionit, z.Fadil Demaku.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtura më 10.04.2015;
3. Raportimi i kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor, z. Fitim Shishani për punën e Inspektoratit për vitin 2014;

4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtura më 10.04.2015

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 10.04.2015, u miratua me vërejtje.

Nga ana e z. Qerim Bajrami u tha që të përfshihet në pjesën ku përflitet fjalimi i tij edhe pyetja që është bërë për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, lidhur me të punësuarit nga ana e komuniteteve jo shumicë në këtë institucion.

3. Raportimi i kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor, z. Fitim Shishani për punën e Inspektoratit për vitin 2014

Fadil Demaku- Fillimisht propozoi që fjalën t'ia jap z. Fitim Shishani për një raportim para anëtarëve të Komisionit dhe më pas të vazhdohet me pyetje nga ana e deputetëve. Pastaj theksoi se raportin vjetor për vitin 2014 e kemi pranuar.

Fitim Shishani- Fillimisht theksoi se mandati ligjor i IPK-së si agjenci e pavarur është që të ndihmoj Policinë e Kosovës në përmirësimin e performancës dhe zbatimin e mandateve ligjore. Nga ana e IPK-së kjo dëshmohej sipas hetimeve dhe inspektimeve që bëhen sipas ligjit. Në përputhje me objektivat e veprimtarisë së IPK-së, që janë parandalimi, zbulimi dhe argumentimi i veprave penale të supozuara që mund të kryhen nga ana e pjesëtarëve të policisë, pa dallim grade dhe pozite, për vitin 2014 janë trajtuar 1304 ankesa, 233 nga këto ankesa kanë qenë me elemente të veprës penale dhe që janë hetuar nga departamenti i hetimeve në kuadër të IPK-së. Kanë qenë 305 punonjës të policisë që për vitin 2014, kanë qenë subjekt i hetimit nga ana e IPK-së, kjo shifër nuk është alarmante pasi vetëm 4% të tyre janë hetuar dhe mund të shpallen edhe të pafajshëm.

Më tutje theksoi se nga 233 vepra me element të veprës penale, prej këtyre janë dërguar në prokuroritë kompetente 132 kallxime penale, 86 raste me raport të veçantë, ndërsa 15 raste janë ende duke u hetuar nga IPK-ja. Gjatë vitit 2014 IPK-ja ka hetuar, katër nënkolonel, një major, katër kapitenë, njëmbëdhjetë togerë, 257 zyrtarë policorë, si dhe dhjetë punonjës nga stafi civil. Rëndësi e veçantë i është kushtuar veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe të detyrës zyrtare, prandaj informoi se për vitin 2014 janë hetuar 83 vepra penale me elemente të korrupsionit dhe kundër detyrës zyrtare. Gjatë vitit 2014 gjithashtu janë ndërmarrë këto masa, 20 arrestime, 64 rekomandime për suspendim, 13 rekomandime për transfer, në bazë të

informacioneve kthyesë që i kemi për rastin e IPK-së që janë dorëzuar prokurorisë. Gjykatat kompetente kanë marrë shtatë vendime: një dënim me burgim me kohëzgjatje një vit, tri dënime me kusht dhe tri dënime me gjobë. Ne kemi identifikur edhe pesë vepra më të përsëritura nga punonjësit policorë për vitin 2014 që janë: 49 raste të rrezikimi të trafikut publik, 48 raste të keqpordorimit të pozitës zyrtare, 13 raste të lëndimit të lehtë trupor, 25 raste të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, 17 raste të kanosjes.

Në vitin 2014 kemi vendosur 45 kuti të ankesave në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe kemi realizuar një numër pa pagesë për qytetarët për të paraqitur ankesat e tyre ndaj punës së personelit policor, numri është 08000333. Në përputhje me planin vjetor të vitit 2014 kemi realizuar edhe pesë inspektime të rregullta edhe dy inspektime të jashtëzakonshme, llojet e inspektimeve të rregullata që i kemi realizuar janë: inspektimi për vlerësimin e implementimit të rekomandimeve nga inspektorati policor për vitin 2012-2013, inspektimi për menaxhimin e thirrjeve në Policinë e Kosovës, inspektimi për të vlerësuar trajnimet dhe njohurit të zyrtarëve policorë lidhur me përdorimin e forcës policore, inspektimi për vlerësimin e menaxhimit të trafikut rrugor në Policinë e Kosovës, inspektimin për vlerësimin e kujdesit të punojësve të Policisë së Kosovës ndaj automjeteve zyrtare, në këtë rast IPK-ja ka inspektuar 149 njësite policore, ka intervistuar 279 punojës policorë, ka kontrolluar 8 390 tiketa për kundërvajtje, ka kontrolluar 590 dosje të ndryshme dhe ka dhënë 50 rekomandime.

Edhe këtë vit kemi vazhduar me trajnime të avancuara të stafit tonë nga ICATAP-i amerikan, do i veçoja tre më kryesoret: teknika e hetimit të krimeve kompjuterike, hetimet e avancuara i vrasjeve dhe shkola e stafit policor të komandës, ku ka qenë pjesëmarrës personeli i IPK-së. Për këtë profesionalizëm të IPK-së ne u jemi mirënjohës ICATIP-it, OSBE-së, EULEX-it dhe çdo agjencie që zbaton ligjin në Kosovë, përfshirë këtu edhe Komisionin tuaj që me sygjerrime dhe rekomandime ka ndihmuar punën e IPK-së, presim në të ardhmen që Inspektorati Policor i Kosovës të zgjerohet.

Fadil Demaku- Pas rasteve që i ka trajtuar IPK-ja, a është vërejtur se është përmirësuar ajo fushë në kuadër të Policisë së Kosovës.

Zafir Berisha- Do të lidhem më një fjalë tuajën z. Shishani, pavarësisht që në raportin tuaj është cekur si shifër prej 305 personave që kanë qenë subjekt i hetimit. Ju treguat që nuk është alarmante, desha të di se si kjo shifër nuk është alarmante, kur 305 punëtorë të Shërbimit Policor janë subjekt i hetimit, kjo do të thotë që në polici kemi ende njerëz që nuk i njohin rregullat dhe ligjet, më nuk mund të themi që Policia e Kosovës është e re, për mua kjo shifër është alarmante në rast se subjekt të hetimit kanë qenë edhe njerëz me grada të larta në shërbimin policor. Ju e përmendët kalimthi që kemi mbi 300 policë në veri që para një kohe të shkurtër janë bërë pjesë të SHPK-së, këta policë a janë duke vepruar në përputhje me ligjet e Kosovës për arsyeje se ne e dimë se njësitet e policisë në atë pjesë janë të dirigjuar nga politika lokale. Inspektorati a ka arritur një shkallë të profesionalizmit që rastet e natyrave të veçanta të kryhen me paanshmëri apo pa ndikime?

Qerim Bajrami- Bëri pyetjen se pasi keni ardhur deri te këto vërejtje, a keni dalë në terren apo vetëm në bazë të ankesave ose ndonjë lajmërimi tjetër nga statcionet policore apo nga qytetarët?

Anton Quni- Unë kam shumë pyetje, para se të kaloj në pyetje kam dëshirë të marr një përgjigje në pyetjen e parë, a keni ndonjë informatë që unë kam bërë ndonjë ndërhyrje te ju, apo vartësit e

juaj, çfarëdo lloj interferimi për gjitha çështjet që ju i menaxhoni, si për shembull në trajtimin e rasteve apo hetimin ndaj zyrtarëve të policisë apo mbrenda organizatës për avancime, a keni ndonjë informatë që kam bërë ndonjë ndërhyrje në agjencinë tuaj?

Fitim Shishani- z. Quni, ju keni qenë ndër më kritikët në kuptimin pozitiv për inspektoratin në të gjitha takimet, për mua ky fakt nuk është i njohur.

Anton Quni- Unë do të kaloj në elaborimin e pyetjeve për z. Shishanin, e para është se sa janë të qëndrueshme opinionet se gjenerata e fundit e inspektorëve të pranuar në IPK janë përzgjedhur falë shumë ndërhyrjeve politike dhe lidhjeve familjare, në vazhdim është pyetja se cili është problemi që keni me gjykatat, të cilat sjellin vendime për t'u ekzekutuar dhe që për ju janë të pa pranueshme?

A qëndron konstatimi që keni angazhuar inspektorë pa përgatitje universitare, kurse më pas njërin e keni regjistruar në Vushtri për të kryer fakultetin deri sa ai ishte në marrëdhënje pune, po ashtu një inspektor që ka të kryet fakultetin e lejoni që të kryejë edhe një fakultet në Vushtri. Udhëzimet administrative që rregullojnë kushtet e punës dhe punësimin ju kanë munësuar që përkohësisht të transferoni personel të niveli zbatues nga institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, kur mendoni t'i ktheni të njëjtit në institucionet prej nga kanë ardhur. A është e vërtetë se një drejtor departamenti është transferuar nga një agjenci tjetër te IPK-ja në pozitë të drejtorit të hetimeve kur dihet se transferet lejohen vetëm për personelin zbatues, jo edhe për atë drejtues menaxherial. A është e vërtetë që keni transferuar nga Policia e Kosovës edhe zyrtarë të administratës duke vendosur në cilësi të inspektorit, të cilin më pas e keni ngritur në udhëheqës divizioni. A është i qëndrueshëm informacioni se ndaj një drejtori tuaj është ngritur kallxim penal dhe përfshirja në veprë penale dhe që pretendohet që i njëjti ka bërë privim të kundërligjshëm të lirisë ndaj një punëtori që tash është larguar nga agjencia juaj.

Dua të dëgjoj një koment tuajin lidhur me mbylljen objektivit të IPK-së gjatë orarit të punës për një aheng familjar. A janë të qëndrueshme informacionet se në disa raste keni angazhuar njerëz në administratë pa proces konkurrimi, kurse më pas keni organizuar konkurse formale, është fjala për një punonjëse apo asistente administrative dhe një zyrtar të personelit? A keni raste të përfshirjes të personelit tuaj në vepra kriminale siç është zbulimi i fshehtësisë zyrtare dhe ndërhyrjes në hetime, është fjala për një rast kur ju e keni hetuar me gjithë ato masta profesionale një zyrtar të policisë por zyrtari i policisë nga vartësi juaj, po ashtu pretendohet edhe nga ju është lajmëruar që të jetë vigjilent, sepse është nën hetime të zyrëtarëve të IPK-së? Gjatë procesit të konkurimit për përzgjedhjen e pozitës tuaj për zgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv, një ndër kriteret ka qenë edhe përvoja menaxheriale, a e keni dokumentuar ju këtë kriter që keni përvojë menaxheriale? A mund të demantoni zërat se disa hetues tuaj janë të afërt apo bashkëpunues me njerëz që konsiderohen se janë të përfshirë apo zyrtar të shërbimit informativ të Kosovës dhe po të njëjtit e kanë një trajtim të veçantë nga ju? A keni informacionin se cili është fati i dosjes së vjedhjes së arit në dhomën e dëshmive në Pejë? A është kryer ndonjë kontroll i jashtëm apo i brendshëm i cilësisë nga ndonjë komision profesional se sa përmbushën standardet e inspektimit, kjo çështje është e paraparë me udhëzimin administrativ. Sa është përmbushur rregulli mbi zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit inspektues, udhëzimi administrativ parasheh që çdo zyrtar i IPK-së t'i kalojë së paku 80 orë trajnime, stërvitje për çdo dy vjet? Me që hetuesit kanë autorizime policore dhe janë të pajisur me armë zjarri, kur ata për herë të fundit kanë kaluar nëpër fazën e ricertifikimit?

Fadil Demaku- z. Shishani, pyttet mund të duken edhe sensitive, por puna jonë është kjo që të kemi transparencë maksimale.

Nuredin Ibishi- Duke pasur parasysh ndihëm e madhe të ICATIP-it, sidomos kur është bërë ligji i dytë i Inspektoratit Policorë në vitin 2010, kur është ndërruar mandati dhe kompetencat e IPK-së, a është IPK-ja funksionale sa i përket aspektit të zbatimit të mandatit në mbikëqyrjen a Policisë së Kosovës/ Kyeshëfi propozon strukturën organizative, kurse ministri e miraton, në planin strategjik tuajin figuron se ai është i miratuar nga ministri në mandatin e kaluar ndërsa në raportin e tashëm ka ndryshime të departamentit për hetimin e integritetit, prej pesë departamenteve ka qenë departament në planin strategjik dhe tash figuron si një divizion në kuadër të një departamenti, departament për hetime speciale. A keni arrestuar ndonjë zyrtar policor në flagrancë kur ka qenë në krye të veprës penale? Aspekti i mbikëqyrjen së masave disiplinore është interesant që nuk përfshihet asnjë zyrtar policor me gradën e kolonelit, që është një pozitë mjaftë e ndishme. Sa reagon shpejt policia në momentin e thirrjes emergjente nga qytetarët? Pse asnjë test të integritetit nuk e keni zbatuar, a është çështja te ju apo të prokurori që duhet të japë lejën. A mendoni që duhet të bëhet më shumë që IPK-ja të jetë më transparente. Policia e Kosovës vazhdon të jetë rob i disa metodologjive të punës duke bërë eksperimente përvetëson këtë metodologji të punës, aspekti i policimit të udhëdhequr nga intelgjencia, aspekti i sektorit të sigurisë, pra pse kur e keni në plan të bëni inspektimin lidhur me metodologjitë e punës të policisë? Pse 3 statcione janë më të prekura me shkeljet nga policia kufitare, siç janë Muçibaba, Kulla edhe Merdari, po ju them edhe tri statcione me numër më të madh të shkeljeve Ferizaj, Gjilani dhe Prizreni.

Fitim Shishani- Ne kemi bërë një numër të madhë të inspektimeve dhe 80 % të rekomandimeve janë zbatuar, ka pasur vështirësi në realizimin e rekomandimeve. Më lejoni t'i përgjigjem pyetjes së z. Berisha, aspekti i alarmantes në lidhje me numrin 305, mundemi të pajtohemi edhe me ty se ne të gjithë dëshirojmë që ta shohim shtetin tonë sa më mirë, por në profesionin policor është e pa mundur sikur të mos bëhet ndonjë shkelje! Po të mos ishin këto shkelje, së pari IPK-ja nuk do të kishte ekzistuar, në secilin vend është organi mbikëqyrës i cili e bënë mbikëqyrjen e veprimeve të policisë. Sa i përket përfshirjes së policisë në veri të Kosovës, kemi marrë veprimet konkrete janë suspenduar katër persona dhe kemi ngritur një kallxim penal, ata të cilët e veshin uniformën e policisë janë nën mbikëqyrjen e IPK-së.

Fadli Demaku- Mendoj që pyetja e z. Berisha për policët në veri është ndër pytet më të rëndësishme edhe për këtë kisha kërkuar një përgjigje më të gjerë dhe më të qartë.

Fitim Shishani- Ne kemi marr informata për hyrjen e një individi në Kosovë, kemi marrë të gjitha veprimet paraprake dhe e kemi vërejtur që katër policët nuk kanë qenë vigjilent për kryerjen e detyrës për kontrollimin e personit që ka hyrë në territorin e Kosovës. Ne kemi kontaktuar Prokurorin Kujdestar, personat janë suspenduar nga ana e drejtorit për 48 orë. Ne kemi vazhduar me suspendim dhe kemi ngritur një kallxim penal që i paraprinë një aktakuze, presim që tani ata të dalin para gjykatës.

Zafir Berisha- Te ndërtimet në Lagjen e Boshnjakëve pjestarët e SHPK-së kanë ndërhyrë, ndonjëherë dhe qytetarët me të drejtë kanë thënë që janë të ndikuar nga kryetarët e komunave. Ne e dimë që kryetari i komunës nuk ka autoritet ligjor për të urdhëruar policinë.

Fitim Shishani- Ne kemi bërë inspektime edhe në pikat kufitare në veri, kemi vizituar edhe personelin atje të policisë. Ne kërkojmë për të shkuar edhe më afër qytetarit me zyrë, të bëhet regjionalizimi i IPK-së, kemi marrëdhënie shumë të mira me policinë në veri dhe me qytetarët. Z.Quni te pytja e parë, se sa janë të qëndrueshme opinionet se gjenerata e fundit e inspektorëve të pranuar në IPK janë përzgjedhur falë shumë ndërhyrjeve politike dhe lidhjeve familjare, ju them që nuk qëndron kjo, ne edhe mundemi ta argumentojmë këtë.

Deputet të nderuar, problemi ynë nuk është me gjykatat, problemi ynë me etikën, me karakterin e institucioneve tona të drejtësisë, të cilat më apo pa dashje nuk i vlerësojnë mirë faktet e qëndrueshme në të gjitha rastet, ato ku z. Quni po i potencon! Unë mendoj që nuk janë për opinion, janë për disa individ që kanë shkelje të rënda të detyrave të punës. Qëllimi im është që IPK-në ta bëjmë shembull për institucionet e tjera.

Anton Quni- Më duhet të ndërhyj në këtë çështje, z. Shishani ju e keni vendimin e Gjykatave relevante në lidhje me çështje që ndërlidhen me zyrtarët e juaj, me konkretisht në rastin e Liridon Gashit, Aziz Nikës, Qazim Veselit dhe Bardhyl Haxhimustafës të gjithë këta janë zyrtarë të IPK-së. A është një vendim i gjykatës dhe ju atë vendim nuk e përfillni?

Fitim Shishani- Edhe sikur të ketë vendim përderisa sa i gjithë personeli i IPK- së ka vërejtur që këta kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës dhe shkelje të tjera, nuk di a ka gjykatë që i kthen një person të korruptuar në punë. Në lidhje me pyetjen për udhëzimet administrative që rregullojnë kushtet e punës dhe punësimin ju kanë munësuar që përkohësisht të transferoni personel të niveli zbatues nga institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, kur mendoni t'i ktheni të njëjtit në institucionet prej nga kanë ardhur, është e vërtetë ky kanë qenë hetues, e kemi marrë prej policisë një person që ka përvojë pune në polici prej 10 viteve ka qenë i përshtatshëm edhe për IPK-në.

Ata punëtorë që i kemi transferuar, janë transferuar përgjithmonë kanë dhënë dorëheqje në polici, drejtori i përgjithshëm e ka nënshkruar atë vendim edhe unë po ashtu dhe këta nuk do të kthehen në polici për një arsyeje të thjeshtë, sepse kanë dhënë dorëheqje. Sa i përket pyetjes se një inspektor që ka të kryer fakultetin e lejoni që të kryejë edhe një fakultet në Vushtri, është e vërtetë ne kemi të drejtë stafin e tyre ta dërgojmë në këtë universitet në Vushtri, i cili sapo është formuar për siguri publike.

A është e vërtetë se një drejtori i departamentit të hetimeve është transferuar nga një agjenci tjetër tek IPK-ja në pozitë të drejtorit të hetimeve, më lejoni të them që një zyrtar është transferuar nga agjencia. Jemi këshilluar me Ministrinë dhe kemi parë se pozitat ishin të njëjta për këtë ishte i mundshëm ky transferim? Sa i përket pyetjes se a kemi transferuar ndonjë zyrtar pa konkurs, është e vërtetë se e kemi transferuar një person, i cili ka punuar në divizionin e ankesave, ai person ka pasur përvojë pune, ka kryer trajnime me ICATIP-in amerikan për hetime, i ka plotësuar kushtet për të qenë zyrtar hetues, jo në pozitën e drejtorit. A është ngritur një kallxim penal për ndonjë drejtor të juajin, sa i përket kësaj pyetje këtë fakt nuk e kam të njohur? Veprimet e kryeshefit të IPK-së, në lidhje me mbylljen e zyreve të IPK-së për një aheng familjar, ne e kemi orarin deri në ora 16, kurse ahengu ka filluar në ora 18, nuk janë mbyllur zyret e IPK-së. A janë të qëndrueshme informatat që disa persona pa konkurs, njëri asistent në administratë edhe tjetri zyrtar personeli janë bërë pjesë e stafit të IPK-së, kjo mundet me ndodhur për shkak të dinamikës së shpejtë të punëve që duhet të kryhen në IPK, por jo me kontratë mbi veprën si ka qenë më parë. Pytja tjetër se a kemi raste të përfshirjes të personelit tuaj në vepra kriminale, siç është zbulimi i fshehtësisë zyrtare dhe ndërhyrjes në hetime, fjala ishte për një rast

kur ne e keni hetuar me gjithë ato masta profesionale një zyrtar të policisë, por zyrtari i policisë nga vartësi juaj është lajmëruar që të jetë vigjilent, sepse është nën hetime të zyrëtarëve të IPK-së, ky fakt nuk qëndron dhe nuk është në etikën time që t'ju tregoj njerzëve që ju jeni nën hetime, kuse sa i përket ndonjë punojësi të IPK-së që ka mundur të zbulojë fshehtësinë zyrtare kemi ndërmarr veprime, kemi pasur një rast ku e kemi dënuar me shtatë ditë suspendim. Z. Quni parashtoj edhe një pyetje se cili është fati i vjedhjes së arit në Pejë, e kemi sçuarar disa herë, ne i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet që na janë dhënë nga Prokuroria dhe gjyqtari i procedurës paraprake. A është kryer ndonjë kontrollim i jashtëm për përmbushjen e standardëve të IPK-së, ju si Komision për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së e keni mbikëqyrrur ligjin në legjislacionin e kaluar, por nuk ka kontrollim më të mirë për IPK-në se Prokurori i Shtetit, me një kontakt me ish -prokurorin e shtetit. Ai befasohet për të mirë, vetëm pesë kallxime penale na janë hedhur poshtë, të gjitha kallximet e tjera penale i ka pranuar prokuroria. Sa është përmbushur rregulli mbi zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit inspektues, udhëzimi administrativ parasheh që çdo zyrtar i IPK-së t'i kalojë së paku 80 orë trajnime, stërvitje për çdo dy vjet, trajnime brenda IPK-s. Ne jemi duke tentuar çdo herë që të kemi zhvillime të avancuara, i kemi nëntë vite që jemi formuar dhe ato transfere që janë bërë kanë ngritur profesionalizëm, nuk e kam asnjë problem të deklaroj që në vitin 2011 nuk kishim përvojë të madhe për hetimin e rasteve por me ndihmën e ICATIP-it dhe transfere të tjera qëndrojmë mirë tani. Vitin e kalur ne e kemi organizuar një manifestim për shënimin e përvjetorit të IPK-së në kuadër të kësaj ne kemi bërë gara për gjuajtje dhe kemi shpallur më të mirët në gjuajtje me armë, ata edhe janë certifikuar.

Anton Quni- Lidhur me informacionin se një zyrtar i juaji është nën hetime, më vjen keq, por është fjala për drejtorin e hetimeve me iniciale J. A. që e ka shfrytëzuar pozitën e tij që ta vënë nën arrest zotërinë, po ashtu zyrtar i juaji më inicialet Q.V. Besoj që e dini në lidhje me çka është fjala edhe lidhur me këtë rast tani ndaj drejtorit të hetimeve zhvillohen hetimet, a është e saktë apo jo? Lidhur me hetimin e Inspektoratit ndaj një zyrtari të policisë të trafikur përgjegjës për autostradë i njëjti është paralajmëruar nga një hetues i juaji se është nën përcjellje, i njëjti e ka zbuluar fshehtësinë zyrtare apo ka ndërhyrë në hetime, ndaj të njëjti ju paskët ndërmarrë masa disiplinore shtatë ditë suspendim, a nuk ju duhet masë shumë e lehtë që krijon një hapsirë që të ngriten teori të ndryshme se rasti trajtohet me standarde të ndryshme. Çështja tjetër është e paraparë në lidhje me kontrollin e inspektoratit të Policisë së Kosovës, punës dhe cilësisë së inspektoratit, një udhëzim administrativ e parasheh që duhet të krijohet një komision profesional. Ne nuk jemi komision profesional, ne jemi komision për mbikëqyrjen demokratike të punës suaj, do të kishte qenë mirë të krijohet një komision nga ekspert të licencuar për të vlerësuar kontrollin e cilësisë e punës së Inspektoratit të Policisë së Kosovës, nuk e them që është përgjigjësi e juaja po thjesht e them si informatë që na duhet ta kemi parasysh në agjendën tonë.

Fitim Shishani- Nuk jam në dijeni që ndaj një drejtori tim është ngritur kallxim penal. Këta individ që ne i kemi larguar për shkelje ligjore, kanë pasur mundësi të ankohen ndaj vendimeve tona. Një zyrtar është paralajmëruar nga një hetues i juaji, po është e vërtetë jemi konsultuar me prokurorin kompetente dhe na ka treguar çfarë masa duhet të marrim. Kalojmë të pytet e z. Ibishi, se a është funksional IPK-ja në zbatimin e ligjit plotësisht, ne mendojmë se veprimtaria e jonë e cila po zhvillohet çdo ditë mendojmë që jemi shumë funksional në zhvillimin e mandatit tonë, sepse ne jemi të autorizuar të zhvillojmë hetime që i udhëheq Prokurori i Shtetit. Sa i përket strukturës organizative, me vjen mirë që e keni vërejtur këtë ndryshim, por siç e dini struktura

mundet me qenë shumë dinamike, çdo gjashtë muaj policia e ndërron strukturën për një arsyeje të thjeshtë, pasi mendojmë që një strukturë tjetër do t'i përshtatet me shumë dinamikës policore. I kemi krijuar disa departamente të reja që quhen divizione, është nënshkruar nga ministri si pako e këtij udhëzimi administrativ. Prej vitit 2012 kemi arrestuar shumë zyrtarë në flagrancë mund të përmendi një në Prizren, pas informacioneve që i kemi pasur nga një qytetarët. Ky rast ka ndodhur në trafik, ku një person zyrtar i merr 100 euro nga një qytetar në këmbim për mos marrjen e gjobës. Pytja tjetër ishte sa i përket masave disiplinore që nuk përfshihet asnjë zyrtar policor me gradën e kolonelit, është e vërtetë, sepse nuk kemi pasur informata që kanë kryer vepra penale kolonelët, kur të kemi ndonjë informatë për ndokënd që mirret me krim nuk na intereson grada.

Arben Vrajolli- Kemi realizuar një inspektim sa i përket reagimit të shpejtë të policisë në momentin e thirrjes emergjente nga qytetarët, sa i përket metodologjisë së matjes duhet që Policia e Kosovës të jetë statike në aspektin e numrit të policëve që patrollojnë në mënyrë që të matet numri i policëve në raport me territorin që e mbulojnë dhe numri i banorëve, duke marrë parasysh që struktura e policisë gjithmonë është dinamike dhe ndryshon nuk mund të nxjerrim një shifër të saktë se sa është mesatarja e intervenimit të zyrtarëve policorë në vendngjarje. Inspekimet tona shkojnë në realcion me mbulueshmërin e periudhës një vjeçare, mbrenda kësaj periudhe kemi ulje dhe ngritje të numrit të policëve kështu që është vështirë të nxirret një shifër.

Fitim Shishani- Lidhur me transparencën, mendoj që ne nuk duhet të përzihemi shumë në organizimin e brendshëm të policiës dhe në fushëveprimtarinë e tyre. Ata e dinë se kur duhet të lajmrohet popullsia dhe cilat segmente duhet të lajmrohen për komisioni tuaj. IPK-ja konsideron që ka transparencë, ndoshta jo të mjaftueshme, siç po e potenconi ju, por janë çështje që operativa e policisë i vlerëson ashtu.

Arberi Vrajolli- Keni përmendur disa statcione që janë specifike ngritje në nivelin e shkejleve, bazuar në këtë raport këto të cilat i shihni kanë dalë nga departamenti i hetimeve, metodologjia e punës tonë bazohet në indikatorë, të gjitha këto shifra janë indikatorë të nivelit të riskut, do të thotë janë statcione që prijnë për nga numri i rasteve dhe pikërisht këta indikatorë hynë si mjet për të realizuar inspektime në të ardhmën. Vitin e ardhshëm ne përgadisim inspeksionin dhe fokusohemi pikërisht në ato statcione me fokus të veçantë.

Strategjitë e IPK-së në inspektime do të thotë janë disa strategji që janë në funksion, inspektimet tona gjithmonë i nxjerrim në bazë të indikatorëve, këta indikatorë ndërlidhen edhe me këto strategji, kemi tentuar që të japim rekomandime në pika të caktuara për përmirësime. Deri tash e kemi pasur një indikator që ndërlidhet me këto strategji, mirëpo në të ardhmën nuk do të thotë që nuk do të fokusohemi konkretisht në implementimin e një strategjie si fokus i veçantë.

Nuredin Ibishi- Gjatë gjithë procedurës Inspektorati e përcjell zyrtarin policor deri në shqiptimin e masave, do të thotë në asnjë rast nuk jeni jashtë procesit, ju më herët treguat që rasin e dërgoni në prokurori edhe prokuroria mirret me rastin më tutje. Në bazë të ligjit jeni të detyruar që ta përcillni rastin. Sa i përket hetimit për integritetin, unë pyeta nëse ka pasur raste që me iniciativën e juaj keni nisur hetime. Kur të bëhet inspektimi duhet të shkon ad-hoc për arsye se ka shumë vonesa, sidomos kur bëhet ndërrimi. Kodi i etikës i Policisë së Kosovës a është kompatibil me Kodin Europian të etikës policore.

Fitim Shishani- Konsideroj që duhet të marrin sygjërimin e fundit në lidhje me inspektimin e pranimit- dorëzimit të ndërrimeve. Reagim i policisë gjatë ndërrimit, ne kemi dhënë disa rekomandime, megjithatë kemi marrë ata faktorë që i ka dhënë komisioni. Hetime të intergriteti të personelit policor në vitin 2014 nuk kemi kryer pasi prokuroria ka vendosur të mos e jap autorizimin për këtë segment.

Arben Vrajolli- Kodi i etikës më shumë është një kod që përcakton edhe hartimin e ligjeve, është një bazë ligjore se si polici duhet të organizohet në vendet gjegjëse. Nëse i referohemi kodit të etikës policore europiane, vetë Inspektoriati Policorë është i bazuar në këtë kod, ku thuhet që është mirë që të ekzistojë një institucion i pavarur që mbikëqyrë punën policore.

Fadil Demaku- Sa është bërë nga ju në fuqizimin e besimit në opinion ndaj Inspektoriatit Policor të Kosovës, duke pasur parasysh se është një institucion shumë i ndishëm, i gjithë sektori i sigurisë përcillet me ndjeshmëri të madhe në nivel vendi, jemi vend në tranzicion dhe ende pa përvojë në fusha të tilla.

Fitim Shishani- Inspektoriati ka fituar besimin në menaxhmentin e vet, në Ministrinë, në opinion dhe në juve, si Komision mbikëqyrës i jashtëm. Në vitin 2012 nuk kemi pasur as një polic, i cili ka ardhur të lajmërojë vetë ndonjë rast ndaj një kolegut i cili ka kryer ndonjë shkelje, por vitin 2014 kemi afër 300 raste të tilla të paraqitjes së rasteve nga policët për kolegët e tyre, pastaj 1300 ankesa nga qytetarët janë shumë, që do të thotë që kemi besim tek opinioni dhe jemi transparent ndaj tyre.

Anton Quni- Mendoj që do duhet t'i kemi edhe disa informata shtesë si aneks të këtij raporti që ne të mos ngutemi me konkludime sot, unë kisha kërkuar nga ju të na ofroni shënime më të detajuara në lidhje me punësimet në IPK për gjatë periudhës katërvjeçare, përfshirë transferet, përgaditjet e kuadrave, ngritjet e tyre në karrierë, procedurat e ndërmarra disiplinore, po ashtu edhe ato procedura motivuese.

Fadil Demaku- Propozimin e z. Quni do e ngrisim në një mbledhje të radhës të Komisionit, pasi të vendosë Komisioni për propozimin e dhënë. Ne do ju bëjmë një kërkesë me shkrim për të dhëna shtesë, deri atëherë nuk jeni të detyruar të ndërmirni asnjë hap.

Qerim Bajrami- Sa të janë të punësuar në Inspektoriat nga komunitetet jo-shumicë dhe nga cili komunitet janë?

Fitim Shishani- Ne kemi të punësuar tre nga komuniteti serb dhe dy nga komuniteti boshnjak në pozita operacionale, hetime dhe inspektive.

4. Të ndryshme

Komisioni vendos që në mbledhjen e ardhshme ta ftojë në takim udhëheqësin e FSK-së, Gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj